



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 12 janar 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të
Lejuar të Fjalëve**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe neneve 36(1) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara ("Udhëzuesi i Punës"),¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 10 janar 2024, ekipet e mbrojtjes të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht "Mbrojtja") dorëzuan Kërkesë të Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve ("Kërkesa")² për përgjigjen e tyre të përbashkët që pritet të dorëzohet të hënën, 15 janar 2024, ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04016, W04019, W04044, W04305, W04361, W04722, W04816, W04850, W04851, dhe W04852 sipas rregullës 153 (përkatësisht "Përgjigjja sipas Rregullës 153" dhe "Mocioni sipas Rregullës 153").³
2. ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk iu përgjigjën Kërkesës.⁴ Sidoqoftë, u shprehën, *inter partes*, se nuk e kundërshtojnë shtimin e kërkuar të fjalëve.⁵

¹ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

² F02050, Mbrojtësit e Specializuar, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 10 janar 2024.

³ F01994, Prokurorja e Specializuar, Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04016, W04019, W04044, W04305, W04361, W04722, W04816, W04850, W04851, dhe W04852 sipas rregullës 153, 8 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-10, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01994/RED).

⁴ CRSPD 402, Mesazh elektronik nga Trupi Gjykses II lidhur me Përgjigjen e NJAGJ-së ndaj Parashtrimit të Protokolluar F2050, 11 janar 2024, konfidencial.

⁵ Kërkesa, para. 4.

II. PARASHTRIMET

3. Mbrojtja kërkon ndryshim të numrit të fjalëve për Përgjigjen e vet sipas Rregullës 153 nga 6,000 në 7,500 fjalë.⁶ Ajo parashtron se: (i) rrethanat e jashtëzakonshme lidhur me gjatësinë, vëllimin dhe shumëllojshmërinë e materialeve që paraqiten në Mocionin sipas Rregullës 153 e përligjin shtimin e kërkuar, pasi kjo i mundëson Mbrojtjes të shprehet plotësisht për çështjen në fjalë;⁷ (ii) dorëzimi i Përgjigjes të përbashkët sipas Rregullës 153 ndihmon në efikasitetin e përgjithshëm;⁸ (iii) nuk i shkaktohet asnjë cenim ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave nga ky shtim fjalësh, të cilin, siç janë shprehur, *inter partes*, nuk e kundërshtojnë;⁹ dhe (iv) Kërkesa është në kohë.¹⁰

III. DISKUTIM

4. Trupi Gjykues konstaton se Kërkesa është dorëzuar në kohë.

5. Trupi Gjykues vlerëson se ekzistojnë në këtë rast rrethana të jashtëzakonshme që përligjin shtimin e numrit të fjalëve. Në veçanti, vëllimi dhe kompleksiteti i materialit relevant për Mocionin sipas Rregullës 153, përbëjnë arsye të vlefshme për miratimin e shtimit të kërkuar. Gjithashtu, synimi i Mbrojtjes për të dorëzuar Përgjigje të përbashkët sipas Rregullës 153 shmang përsëritjet e panevojshme e për rrjedhojë ndihmon në efikasitetin e përgjithshëm.

6. Trupi Gjykues më tej mban parasysh se ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave janë shprehur *inter partes* se nuk e kundërshtojnë Kërkesën dhe se nuk u shkaktohet asnjë cenim nga miratimi i shtimit të kërkuar të numrit të fjalëve.

⁶ Kërkesa, para. 1, 6.

⁷ Kërkesa, para. 2.

⁸ Kërkesa, para. 3.

⁹ Kërkesa, para. 4.

¹⁰ Kërkesa, para. 5.

IV. VENDIM

7. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b) **SHTON** numrin e lejuar të fjalëve për Përgjigjen sipas Rregullës 153 në jo më shumë se **7.500 fjalë**.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E premte, 12 janar 2024

Në Hagë, Holandë